



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Nr. ____ Prot

Dokument parlamentar

Tiranë, 18. 07. 2018

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 69/2012, “PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjet e tij të datave 17 dhe 18.07.2018, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, propozim i Këshillit të Ministrave.

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën, neni 81, pika 1 të saj. Në përmbajtje të dispozitave të këtij projektligji nuk ka formulime, që vijnë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.

Në aspektin procedural, projektligji vjen si nismë legislative e Këshillit të Ministrave, është depozituar në Kuvend dhe i është nënshtruar rregullave procedurale të shqyrtimit e miratimit të projektligjeve sipas Rregullores së Kuvendit.

Gjatë diskutimit në parim të projektligjit ishin të pranishëm znj. Lindita NIKOLLA, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Besa Shahini, Zv/Ministre e MASR, znj. Zamira Gjini, Drejtore e Përgjithshme për Politikën dhe Zhvillimin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Gerti Janaqi, Drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit, z. Erzen Tola, Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, si dhe z. Jetlir Gjergji dhe z. Mariglen Mërtiri, këshilltar në MASR.

Komisioni organizoi seanca dëgjimore me Prof. Dr. Roland Zisi, rektor i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë; Prof. Asoc. Dr. Valbona Duri, Zv/ rektore e Universitetit “Eqerem Cabej” Gjirokatër; Dr. Eranda Bilali (Halluni) përgjegjëse e Departamentit të Mësuesisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër; z. Arjan Dyrmishi, kryetar i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë; z. Nevruz Kaptelli, kryetari i Sindikatës së Pavarur të Arsimitarëve; z. Kolë Nikollaj, president i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë; përfaqësues të tjerë të këtyre sindikatave; znj. Albana Mustafaraj dhe z. Klaudio Pulaha, përfaqësues të Kualicionit për Arsimin në Shqipëri; znj. Liria Dina, Altea Lula përfaqësuese të Qendrës për Arsim Cilësor dhe znj. Ekflodia Leskaj, Jonida Lamaj, përfaqësuese të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF).

Gjatë diskutimit në parim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në seancat dëgjimore të organizuara me aktorët e interesit për këtë projektligj, opozita mori pjesë në mbledhje, ndërsa në diskutimin dhe votimin nën për nen të tij nuk mori pjesë. Në diskutimin në parim opozita votoi kundër.

Sipas deputetëve të opozitës koha e diskutimit të projektligjit ishte shumë e shkurtër, fundi i sesionit kur vemendja e grupeve të interesit është minimale, kjo është një arsye për të kërkuar shtyerjen e miratimit të këtij projektligji, për ta lënë në një sesion tjetër. Po kështu deputetët e opozitës u shprehën se ligji bie në kundërshtim me ligjin e arsimit të lartë, Ministria nuk mund të zhvillojë programe studimi, sepse të drejtën e kanë departamentet dhe fakultetet në hartimin e programeve.

Opozita kundërshton përbërjen e Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, si dhe shkollën e drejtorëve.

Deputetët e opozitës u shprehën për mungesë buxheti në fushën e arsimit si dhe paga të ulta për mësimdhënësit etj.

Deputetët e mazhorancës në Komision, si në diskutimin në parim dhe nën për nën vlerësuan se:

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara në projektligjin e propozuar nga Këshilli i Ministrave kanë për qëllim të përmirësojnë aspekte të ndryshme si dhe nën të veçanta të ligjit në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar, për një funksionim dhe organizim më të përsosur të tij, në harmonizim të plotë me kuadrin ligjor të përparuar evropian, për të zbatuar standartet bashkëkohore.

Efikasiteti në zbatueshmërinë e ligjit dhe mbështetja e reformës në sistemin e arsimit parauniversitar janë qëllimi kryesor i këtij projektligji. Po kështu ndryshimet e propozuara janë në funksion të sigurimit të cilësisë dhe rritjes së efikasitetit dhe performancës në gjithë sistemin tonë arsimor parauniversitar.

Rritja e efikasitetit në tërë nivelet e këtij sistemi arsimor është detyrë parësore e Qeverisë, ministrive të linjës, institucioneve ligjzbatuese në nivel qendror dhe vendor.

Riorganizimi i institucioneve të varësisë, përfshirja dhe fuqizimi i rolit të komunitetit prindëror në hartimin dhe zbatimin e politikave arsimore, përmirësimi i cilësisë së drejtimit dhe administrimit të institucioneve shkollore, parimi i meritokracisë, parimi i transparencës si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore potenciale për ushtrimin e profesionit të mësuesit janë në fokusin e ndryshimeve që sjell ky projektligj.

Risi të këtij projektligji mund të përmendim “Vlerësimin e jashtëm të arritjeve shkollore në arsimin fillor”, testimin online të mësuesve, certifikimin e drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare dhe portalin “Mësues për Shqipërinë”, të cilët janë në shërbim të rritjes dhe të sigurimit të cilësisë së drejtimit, administrimit dhe mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet arsimore. Gjithashtu portali “Mësues për Shqipërinë” paraqet interes të veçantë, sidomos në lidhje me transparencën në konkurimet dhe rekrutimin në bazë të meritës së kandidatëve për vende të reja të punës.

Në projektligj parashikohet krijimi i regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe në diasporë, si dhe pajisja me certifikatë e nxënësve, po në diasporë, pas përfundimit të programit të gjuhës shqipe.

Në këtë projektligj qartësohet niveli arsimor i kandidatëve për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit në tërë nivelet e sistemit arsimor parauniversitar, në zbatim dhe të

detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, qoftë ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ashtu dhe detyrimit për të dhënë provimin e shtetit sipas ligjit nr. 10717, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë kuadër projekligji merr në konsideratë të gjitha burimet njerëzore që nuk kanë titullin “ mësues”, por disponojnë diploma të përafërta me lëndët që zbatohen në kurrikula arsimore të sistemit parauniversitar.

Projektligji ka zgjidhur dhe shqetësimet për efekt page të studimeve të kryera në ish institutet e larta pedagogjike, duke u njohur 8 semestra.

Në projekligj zhvillohen më tej parimet e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Përmes këtij projekligji rregullohet përbërja e Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, si rrjedhojë e ndryshimeve të bëra në emërtimin e ministrive që bëjnë pjesë në këtë Këshill, si dhe riorganizimi administrativ i njësive të pushtetit të vetëqeverisjes vendore, ku tashmë është suprimuar komuna.

Në dobi të funksionimit si duhet të lidhjes së shkollës me komunitetin, për të siguruar arsimim sa më cilësor, ky projektligj krijon bazën ligjore për një strukturë të re, Këshillin Kombëtar të Prindërve, i cili do jetë një strukturë ligjore që përfshihet në partneritetin dhe vendimarrjet e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar. Ky Këshill do shërbejë si interlekutori kryesor në komunikimin efektiv mes MASR-së dhe prindërve. Për rrjedhojë do funksionojnë më mirë mekanizmat e përgjegjshmërisë dhe transparencës.

Misioni dhe detyra për përmirësimin cilësor të procesit mësimor edukativ në sistemin arsimor parauniversitar nuk mund të arrihet pa një drejtim dhe menaxhim si duhet të shkollave. Është kjo arsyeja që edhe në këtë projektligj përcaktohen qartë aftësitë dhe kompetencat që duhet të ketë drejtori dhe nëndrejtori i institucionit arsimor, me qëllim që të kemi një administrim cilësor të këtij institucioni. Këtij qëllimi i shërben *Shkolla e Drejtorëve*, e cila do ngrihet nga bashkëpunimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Fondacioni Shqiptaro –Amerikan për Zhvillim, si person juridik me pavarësi drejtuese, administrative, financiare e teknike, nën mbyqyrjen e MASR.

Në projektligj parashikohet krijimi i mundësive konkrete për institucionet arsimore për krijimin dhe vetëadministrimin e të ardhurave, që këto institucione krijojnë nëpërmjet shërbimeve ndaj të tretëve.

Me interes për projektligjin e ri është mekanizmi i ri ligjor duke ju deleguar njësive të vetëqeverisjes vendore kompetenca në menaxhimin e punonjësve mësimorë dhe emërimin e shkarkimin e drejtuesit të arsimit parashkollor nga kryetari i bashkisë, në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër projektligji shënon një qasje të re për funksionimin dhe organizimin e institucioneve përgjegjëse për sistemin arsimor parauniversitar në drejtim të rritjes së cilësisë.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen Komisioni bëri propozimin e poshtë shënuar:

Neni 6 të formulohet:

“Neni 6

Pika 4, e nenit 29, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga gjashtëmbëdhjetë anëtarë, me këtë përbërje:

- a) përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për financat;*
- b) përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike;*
- c) përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes sociale;*
- ç) përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për diasporën;*
- d) përfaqësuesi i shoqatës së bashkive me numrin më të madh të bashkive;*
- dh) përfaqësuesi i Këshillit Kombëtar të Prindërve;*
- e) dy përfaqësues nga partnerët socialë;*
- ë) një përfaqësues nga shoqëria civile;*
- f) një përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë;*
- g) gjashtë personalitete të njohura për kontribute në fushën e arsimit e të shkencës dhe në jetën publike.*

Përfaqësuesit në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, sipas germave “ë”, “f” dhe “g” zgjidhen me konkurrim publik.”.

Në përfundim, Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit vendosi me shumicë votash miratimin e tij në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe e përcjell për miratim në séance plenare.

RELATORE

Adelina RISTA

ZV/ KRYETARE

Milva EKONOMI